Per qarqet e dritave te sigurise kabllot do te jene me izolim te dyfishte te tipit rezistent nga zjarri FTG-OM1.

Te gjithë kabllot do te verifikohen dhe llogariten sipas:

- qellimit te perdorimit
- verifikimit te renies se tensionit
- verifikimit te nxehjes gjate lidhjeve te shkurtra

Tela duhet të jene përçues bakritë izoluar me PVC me bërthamë të vetme brenda përçuesit.

Telat e izoluar duhet të jetë me ngjyrë me të errët për të identifikuar fazë dhe neutrin.



Të gjitha rastet kur kabllo PVC përfundojë në një bord të shpërndarjes së siguresave, pajisjet elektrike, etj duhet të lihen të lira një sasi të lejuar për të nxjerre me vone në rast se duhet pa shkaktuar tërheqjen e tyre.

Numri i kabllove të instaluar në tuba ose kanalina duhet të jenë të tilla që të mundësojnë etiketimin të lehtë pa dëmtuar kabllo dhe kurrë nuk duhet të jetë më shumë se 40%.

Izolimi PVC i kabllove dhe telave të shumëfishtë ose me tel të vetëm duhet të jenë të afte që të rezistojë deri 600/1000V.

Të gjithë kabllo të vendosura brenda tubave duhet të izolohehen me përçueshmëri të lartë PVC.

Kabllo fleksibël të përbëhen nga tela me shumë shirita dhe në varësi të asaj që ne kemi:

- Kabell me tre tela, 1 neutri, 1 toka (për sistemin mono fazë)
- Kabell me katër tela, 3 faze dhe 1 neutri (për sistemin trefazor, pa tokezim)
- Kabell me pesë tela, 3 faza dhe 1 neutri dhe 1 toka (për sistemin trefazor me tokezim)

Perzgjedhja e seksionit të kabllove është bërë duke pasur parasysh sa më poshtë:

Rryma e lejuar

Ib – Rryma e llogaritur e qarkut

Ia – Rryma e pajisjes/ve mbrojtëse (automat/siguresë)

Iz – Rryma e lejuar e kabllit

$$I_b < I_n < I_z$$

Rryma e veprimit të sigurtë të automatit është zgjedhur duke ndjekur të dhënat e mëposhtme:

- 1.3 Iz – SSH EN 60947-2

- 1.45 Iz – SSH IEC 898-2

$$I_f < 1.3 I_z$$

Ku, If është rryma konvencionale e punës së automatit

Verifikimi i ngrohjes termike të kabllove është arritur duke ndjekur parametrat e listuar sa më poshtë dhe me rregullime për raste specifike që kërkonin ndërhyrje teknike:

I_{2t} – Energjia tranzitore gjatë procesit të lidhjes së shkurtër

k – Koeficienti në funksion të kabllit

S – seksioni i kabllit

$$I_{2t} \leq k^2 S^2$$

Verifikimi i rënies së tensionit është kryer me të dhënat e listuara më poshtë:

K – koeficienti i qarqeve trefazore, K=1.73

L – gjatësia në km të linjes elektrike

R – reaktanca e kabllit

X – induktanca e kabllit

$$\Delta U = K * I_b * (R * \cos \varphi + X * \sin \varphi)$$

Kjo rënie e tensionit duhet të jetë ≤4% për linjat e shpërndarjes së fuqisë dhe ≤3% për linjat

e furnizimit të ndricimit. Eshtë marre parasysh programi i përgjithshëm i instalimeve dhe llogaritjet e mesiperme për rregullimin e renieve të tensionit në rrjet. Llogaritja dhe dimensionimi i kabllave nga transformatori deri në konsumatorin e fundit të dhëna:

Koeficienti i njekoheshmerise K_c - 0.7
Korrigjimi i faktorit të fuqisë $\cos \varphi$ - 0.94

Për përcaktimin e renieve të tensionit kemi marre parasysh të dhënat e mëposhtme:

- Seksioni I urave në TU të transformatorit deri në panelin BT dhe gjatësia e tyre
- Seksioni I kabllit që furnizon njerin nga panelet e matësive të energjisë
- Gjatësia e kabllit nga paneli I matësive të energjisë deri në kuadrin e shpërndarjes

Meqenëse këto të dhëna nuk janë të paraqitura vizatime:

- Bazuar në fuqinë e transformatorit kemi përcaktuar seksionin e kabllave të urave në TU.

Përcaktimi i rrymës së ngarkesës së panelit është bërë me keta të dhëna:

$$I_b = P_{in} / (\sqrt{3} * U_n * \cos \varphi)$$

K_u ,

I_b – rryma nominale e panelit

P_{in} – fuqia e instaluar për një panel matjeje

U_n – tensioni nominal i panelit

b) Kanalinat dhe aksesoret

Instalimi elektrik mund të bëhet në këto mënyra :

- Në tuba metalik mbi sipërfaqe dhe kanalina metalike
- Pajisje e instalimit mbi suva janë:
- Tub fleksibël PVC me dimensione të ndryshme në varësi të dimensionit dhe numri i telave që do të vendosen në të, gjithmone brenda në kanaline, nuk do kete instalim mbi sipërfaqen e drurit me PVC
 - Kutitë e shpërndarjes
 - Kanalina metalike
 - Tub metalik mbi sipërfaqe
- Kanalinat dhe tubat PVC fleksibël duhet të fiksohen në distancë prej 0.4 m pezull nga tavani dhe në mënyrë horizontale ose vertikale drejt prizave ose celesave pa krijuar harqe ose kende.

c) Tuba, kutite

Brenda objektit të gjithë kabllot do të jenë të vendosur sipas vizatimit të instalimeve. Ndryshimi i llojit të instalimit duhet të bëhet me një kuti inkaso.



Kutite shpërndarjes, në varësi të sistemit që do të përdoret, të fshehura dhe në kanaline dhe instalimi do bëhet me vidë.

Materialet dhe karakteristike të tyre teknike janë të njëjta si për tubat fleksibël.

Dimensionet e kutive të shpërndarjes ndryshojnë sipas rrethanave dhe nevojave. Ata janë në formë rrethore, katrore, drejtkëndësh dhe kapaket e tyre mbulues janë me ngjyra të ndryshme.

Është e rëndësishme që lidhja e kabllave ose telave brenda kutive do të ishte realizuar me xhunto.



Të gjitha kabllot duhet të etiketohet sipas skemës së paneleve të shpërndarjes me numrin e tyre të qarkut.

e) *Sistemi i kanalinave*

Nëse kabllot ose përçues janë instaluar për përdorim të mëvonshëm apo hapësirë të lirë kjo do të shënohet edhe në etiketë.

I njëjti informacion duhet të sigurohet në të dy skajet e kabllave dhe përçues.

Sistemet e kanalinave të sistemit nën suva me tuba fleksibël duhet të përfundojnë në përputhje me të gjitha kushtet teknike të instalimit elektrik

Sistemi i kanalinave duhet të jetë sipas standardeve të duhura.

- Sistemi i kanalinave të përbëhet nga pajisje të tilla si:
- Kanalina me dimensione të ndryshme, në varësi të numrit të telave / kabllave, prizave, çelsave etj, të jetë e instaluar në të me gjatësi 2 m
- Këndet (shërbejnë për të formuar një kënd në instalimin) që varen nga kanalet që janë përdorur
- Devijimi në formë T
- Kanalina me dy divizione të veçanta.

Montimi i kanalinave të bëhet me vida, dhe të vihet 0.4m nën nivelin e tavan.

f) *Ndriçuesat*

Të gjithë ndriçuesit duhet të jenë të pajisur me drosela elektronike me përjashtim kur janë të prodhuar ndryshe, me terminale (seksioni min. 2,5 mm²) dhe terminaleve të dyta për të lidhur një ndriçues në vijim. Në rastin e lidhjeve të dy kabllave në një instalim duhet të ketë edhe dy kabllot me mbrojtje në bazë të shkallës mbrojtjes.

Të gjithë ndriçuesit e brendshëm janë të pajisura me llambat LED sipas zgjidhjes arkitektonike. Për të gjitha rastet do të përdoret ndriçim me rezistence të larta prej instalimit të jashtëm. Kabllot do të përdoren sipas specifikave të fabrikës.

Pamja dhe karakteristikat e shpërndarjes së ndriçuesve duhet të përputhen me informacionin e detajuar dhe në materialin specifikim.

Në situata të ndryshme sipas kërkesave duhet të përdoren llambat e ndryshme, referuar specifikimeve teknike për:

- Ndricimin e brendshëm
- Ndricimin e jashtëm

ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E061013



Produktet:

Ndriculesit gjenden ne 7 tipe

a)Ndriculesi tipi 1_Ndricules mural per ndricimin e shafteve + Tipi 6_Ndricules mural

E ndertuar me alumin te derdhur, ky ndricues per instalime mureore ne ambjente te jashtme eshte nje dizajn minimalst dhe dimensione kompakte.Mund te instalohet me variante me ndricim nga te dy anet e tij(siper e poshte). I pajisur me xham sigurie transparent, te montuar ne pjesen e perpparme. Prize standarte GU10 qe lejon zevendesim te burimit LED ne fund te jetegjatesise.

Fuqia:5W ose 2x5W

Pesha: 0.6kg

Furnizimi:220-240V

Izolimi:Klasi 1

IK05

IP65

4000K



b)Ndriculesi tipi 2_Spote inkaso per vazot + Tipi 5_Ndricules tokesor per shkallet

Ndricules spot pa vida te dukshme, i bere me rezine rezistente ndaj impakteve, stabilizuar ndaj rrezeve UV dhe me mbrojtje ndaj ndryshkjes. Gjendet ne dy variante, nje me mbulim me rezine, qe do perdoret per shkallet dhe nje pa mbulese qe do perdoret per te ndricuar vazot nga poshte. Furnizihet me llambe LED GU10 te certifikuar me temperature ndricimi te rregullueshme

Fuqia:3.55W

Furnizimi:220-240V

Izolimi:Klasi 2

IK05

IP67

4000K

c)Ndriculesi tipi 3_Ndricules i varur

Ndricules i varur me shperndarje ndricimi. Trup alumini i llakuar me ngjyre te zeze. Difuzor optik ne PC opale. Kablli i varjes gjer ne 22m me kabell koaksial te perforcuar me kevlar. Nderpresesi elektronik me mekanizem optik dhe dimmer. Dimmer i perfshire.

Fuqia:21W

Furnizimi:220-240V

Izolimi:Klasi 1

Pesha:1.11kg

IP20

4000K

ING. DESHIRAMEN

NR. LIC. E 0610/3



d)Ndriculesi tipi 4_ Ndricules projektor LED per strukturen

Ndricules projektor ne trup plastik me boje te zeze rezistente ndaj ujit.. Difuzor optik. Llambe me standard LED GU10. Kendi i ndricuesit i rregullueshem.

Fuqia:50W

Furnizimi:220-240V

Izolimi:Klasi 1

Pesha:0.6kg

IP77

IK06

4000K



d)Ndriculesi tipi 7_ Ndricules shirit LED

Ndricules shirit per ambjente te jashtme. Instalimi me fiksim ne siperfaqe ose plafon. Per tu fiksuar perdor nje nastro 3M VHB ne akrilik dhe stafeta ne silikon.

Fuqia:80W

Furnizimi:220-240V

Izolimi:Klasi 1

Pesha:0.35kg

IP68

IK05

4000K

NDRIÇIMI EMERGJENT DHE SHENJAT EXIT

Nje sistem i monitorueshem i ndricimit emergjent do te instalohet.

Të gjitha elementet duhet të pajisen me funksion automatik provë, e cila në mënyrë automatike kryen monitorimin periodik të gjendjes së ndricuesve dhe baterive, gjithashtu ka aftësinë për të kaluar rregjim pune te adresueshem dhe të shohin gjendjen e te gjitha pajisjeve ne teresi ose të një zone ne ekranin e instaluar ne mur.

Verifikimi i gjendjes te elementeve te sistemit do te sigurohet :

- Si ne nivel lokal nga personeli i mirembajtjes i cili ne menyre periodike do te duhet te kaloje neper te gjithe ndertesen per te verifikuar nese eshte ndezur drita e verdhe tek ndricuesit i cili sinjalizon qe ai nuk eshte ne pune.

- Ashtu edhe nga sistemi i monitorimit, të instaluar në ndërtesë, ku pajisjet janë te adresueshme, te lidhura me PC e monitorimit nëpërmjet sistemit BUS i cili lejon personelin e mirëmbajtjes për të kontrolluar në çdo kohë në ekranin e tij, gjendjen e pajisjeve te emergjences, pa lëvizur. Software i monitorimit te sistemit do te shfaqin dhe identifikojne elementet e sistemit direkt ne ekran. Pajisjet e demtuara do të shfaqen me shenja të veçanta për të njoftuar personelin e mirëmbajtjes. Planet e

nderteses ne autocad mund te integrohen direkt ne software-in e menaxhimit i cili eshte lehtesisht i menaxhueshem edhe ne rast te ndryshimeve te planeve qe mund te pesoje arkitektura e objektit.

Ndriçimit emergjent duhet të përmbushë kërkesat e EN 1838. Përveç kësaj disa ndricime të korridoreve janë të furnizuara nga UPS, kështu që ka vetem ndricim evakuimi me ane te tabelave EXIT.

Drita emergjente duhet të instalohet në të gjitha korridoret, nga ana e daljes se shkallëve, etj, në bazë të projektimit.

Drita emergjente është furnizuar nga UPS . Bateritë mund të ofrojnë të gjithë ndriçimin për një orë. Tabelat duhet të jenë ngjyre e gjelbër dhe me shenja përkatëse:

- Një njeri që vrapon
- Shigjete që tregon drejtimin e daljes.
- Fjala dalje shkruar në ngjyrë të bardhë.



3. Prizat

SENSORET E NDRICIMIT

Detajet për modelin e sensorit te ndricimit, Specifikimet teknike:

- tensionit ushqyes: 220-240 V / ~ 50-60Hz
- rele dalese: 6 A ~ 220V
- ngarkesa të kontrollueshme:
- koha vonesë e rregullueshme nga 15 sec. ne rreth 3 min.
- Temperatura Operative: 0-40 ° C
- 10 m distanca max e zbulimit (zakonisht 8 m)
- Niveli për instalimin e sensorit h = 1,1-1,2 m

Kendi i zbulimit minimal:

- 100 ° horizontalisht
- 32 ° min vertikalisht

PRIZAT

Një sistem i plotë i njësive të sigurohet në pozicionin e treguar në vizatimet e bëra nga inxhinieri elektrik i projektit.

Të gjitha prizat e montuara në objekt do të jenë te tipit të tokëzuar dhe të mbrohen për njerëzit.

Prizat të jetë te llojit mbi siperfaqe.

Një prize tensioni nje fazore ka një gjilpërë me kokë për fazën. Një për neutral dhe një për tokë ndryshe të specifikuara, duhet të jetë prej 16 amper me 2 pine dhe të jetë jashtë sipërfaqes.

Të gjitha prizat duhet të jenë te ngjashme me siguresat, 250 V, 2P 16A.

4. Sistemet e komunikimit

Rrjeti LAN, Internet dhe telefonik i brendshem do të instalohet në përputhje me normat dhe standardet qe formojnë kërkesat e përfituesit. Ky sistem do të jetë i veçantë për çdo post pune dhe komunikimi mes tyre do të bëhet nga serveri, të instaluar në një zonë të veçantë, duke siguruar të gjitha kriteret e kërkesat e sigurisë për këtë lloj fushash si zgjidhja arkitektonike është dhënë. Komunikimi i të dhënave do të bëhet nga çdo pajisje si Rack, UPS, kalon panele patch, linjat e komunikimit etj, i cili do të jetë i instaluar i ndarë nga çdo rrjetë sistemit dhe do integrohet me sistemin aktual te godines.

5. Sistemi i alarmit te zjarrit

Do të jetë i instaluar një sistem i zbulimit dhe i alarmit të zjarrit për çdo fushë e sipas standardeve. Sistemi do të jetë inteligjent, i adresueshem ku çdo sensor do të sinjalizojë për çdo fushë që ai mbulon. Centrali i zjarrit ekzistues, me të cilin do lidhen pajisjet e listuara me poshte analizon pendren e sinjalit dhe kur ai është i sigurt për zjarrin jep alarmin. Njoftimi është bërë nga disa mënyra, përmes sirenave të instaluar jashtë, përmes kutive të instaluar në ndërtesë dhe me anë të telefonit fiks apo celular për ndërhyrjen në këto raste.

Sistemi i zbulimi te zjarrit do të jetë i pershtatshem sipas fushave me detektorë tymi, temperatura, gazit etj, të cilat do të jenë elemente të veçanta të lidhura në rrjet BUS dhe komunikimi me mbrojtje aktive nga zjarri për të dhënë mesazhin për aktive se ajo e fundit në rast të ndërhyrjes automatike për zjarr zjarrfikës.

Detektor Tym i Adresuar

Detektor i tymit duhet te kete keto funksione:

- Te jete i besueshem dhe i sakte.
- Detektim shume i shpejt i tymit me versionin dual-optik (Dual-Ray Techonolgy).
- Te monitoroj ambientin per influence elektromagnetike per te shmangur alarmin false.
- Te kete adresim manual dhe automatik.
- Te kete struktura fleksible te networkut duke perfshire T-Tapping pa asnje element shtese.
- Te manaxhoje deri ne 254 elemente ne loop..
- Te kete dopio izolator te integruar
- Led tregues alarmi i dukshem ne 360 grad
- Tensioni i punes: 15 V DC deri ne 33 V DC.
- Konsumi i rrymes: <0.55 mA.
- Output i alarmit:
- Output i treguesit: Open Collector lidh 0 V me 1.5kΩ max 15 mA.
- Temperatura e punes: -20°C -+ 50°C.
- Temperatura e ruajtjes: -25°C -+ 80°C.
- Lageshtira e lejuar: 95% (Pa kondense).
- Shpejtesia e ajrit: 20m/s.
- Niveli i mbrojtjes: IP 40.

Buton Zjarri Adresuar

- Aktivizim i alarmit duke shtypur butonin ose duke thyer pjesen e xhamit
- Display LED per alarmin e aktivizuar ose per inspektim.
- Call point individuale qe lejon lokalizim te shpejt te zones.
- Dopio izolator i integruar
- Te jete me ngjyre te kuqe
- Tensioni i punes: 15 V DC deri ne 33 V DC.
- Konsumi i rrymes: 0.4 mA.
- Materiali i kases: Plastik.
- Kushtet e ambientit:
- Temperatura e punes: -25°C deri ne +70°C.
- Lageshtira e lejuar: <95% (pa kondensim).
- Te plotesoj normativat EN 54-11, EN 54-17
- Niveli i mbrojtjes: IP54.

- Sirene Zjarri.

- Te jete ne perputhje me normativat EN54-3 dhe EN54-23
- Te kete tone DIN 33404
- Volumi deri ne 102 dB.
- Te kete dopio izolator te integruar
- Te kete shkalle te ndryshme te flashimit.
- Te kete teknologji LED.
- Te ofroje deri ne 32 tipe tonesh te ndryshme
- Flashi i paisjes te jete sipas standartit EN54-23.
- Tonet dhe volumi te vendosen nepermjet DIP switch-eve.
- Tensioni i punes: 18-30V DC/ 9-15V DC
- Monitorimi: Polariteti i ndryshueshem
- Konsumi i rrymes: ne alarm 3.85mA
- Temperatura e punes: -25°C -+ 70°C
- Lageshtia e lejuar: ne perputhje me EN54-23
- Lartesia maksimale e montimit: 2.4m
- Frekuenca e flashit: 1Hz
- Ngjyra e flashit: E kuqe ose e bardhe
- Niveli maksimal 102 dB.



Modul dalje ne loop

Moduli duhet te kete keto specifika:

- Celes te rrotullueshem per adresim automatik ose manual
- Kontroll i sinjalit per linje te invertuar
- Te kete izolator ne linjen e bus per te mbrojtur nga lidhja e shkurter
- Te monitoroje ushqimin e jashtem per paisjen
- Shfaq statusin me ane te LED sinjalizimi
- Tensioni hyres: 15VDC deri ne 33VDC
- Konsumi maksimal i rrymes:
- Nga loop: 6.06 mA (ne pune normale dhe alarm)
- Nga ushqimi i jashtem 15mA (ne pune normale)
- Power supply i jashtem: 20.4 VDC deri ne 29 VDC
- Rryma maksimale dalese: 3A

Barriera Detektuese te tymit

- Te kene zone te gjere veprimi.
- Te kene kompensim automatike per ndotjen
- Te kene Sinjalizues Led ne njesine e kontrillit per stade te ndryshme operimi.
- Tensioni i punes: 10 V DC deri ne 30 V DC
- Konsumi i rrymes: Ne standby 4 mA@24V Ne Alarme <15 mA
- Resetim per shkak te shkeputjes se energjise >5s
- Dimensionet: 126 x 210 x 120 mm ose te peraferta



Tabela Exit



- Te perdori teknologjine Led.
- Te jene ne perputhje me standartin EN60598-2-22
- Paneli i sinjalizimit te jete ne perputhje me standartin EN1838
- Te perdori bateri me jetegjatesi mbi 4 vjet
- Distanca e shkiueshmerise te jete mbi 30m

Elektromagnet per dyert e emergjences

- Tension i punes: 12/24 Vdc
- Rryme: 500 mA ne 12 V / 250 mA ne 24 V
- Pesha mbajttese: 300 Kg.



6. Sistemi CCTV

Në përputhje me kërkesat dhe standardet e instalimit do të parashikohet një sistem CCTV për objektin. Ai do të mbulojë fushat e nevojshme, të kërkuara nga përfituesit, Në bazë të këtyre kërkesave të veçanta, do të jetë zgjedhja e pajisjeve që përmbush këto kërkesa. Do të përdoren kamera luajtshme, të pershtatshme për instalimin, mbrojtjen anti-ndërhyrje, me IP-66 rast dhe me zbulimin lëvizje etj

Për zonën e brendshme do të përdoret kamera me rezolucion të lartë, të vendosur në pikat kyçe të monitorimit. Të gjitha të dhënat e do të regjistrohen në pajisje regjistrimi NVR ekzistuese të godines, i cili do të realizohet në dhomën e serverit ekzistues. Në dhomën e monitorimit do të shfaqet imazhet e kamerave në internet e cila mbulon të gjithë ata të ndarë në ekran në sa kamera ne kemi.

Të gjitha instalimet dhe sistemi i konfigurimit do të bëhet nga kontraktuesi.

TELEKAMERA BULLET IP , INTELIGJENTE ME ANALIZE VIDEO

Per detyren qe do te kryejne keto kamera duhet te :

- Te beje pozicionimin (pan, tilt, roll, zoom) ne remote ose wireless pa qene nevojte te preket kamera (kjo gje ndihmon nese ne te ardhmen duam te ndryshojme fushepamjen).
- Analize video e integruar ne kamer.
- Rezolucion te larte 4MP dhe sensor te madh 1/1.8" per te kapur pamje te qarte dhe ne mungese te drites.
- Kompensim te madh drite (HDR) per te pare cdo detaje edhe ne skenat e erreta me mungese drite por dhe ne skenat me ndricim te larte.
- Te kete memorie lokale (SD Card) dhe ne mungese te lidhjes me serveri te regjistroje ne memorie lokale. Ne momentin e lidhjes regjistrimet ne memorien lokale ti kalojne automatikisht serverit.
- Te kete dy slote per SD card industriale. Keto slote te mund te konfigurohen si mirror ose failover.
- Te kete mbrojtje dhe siguri te larte te te dhenave



Funksionet Video – ALC

- Dite/Nate – Auto, Me ngjyra, Bardh e Zi.
- Ekspozimi – AES (Automatic Electronic Shutter), Fikse (1/25 deri ne 1/15000).
- Reduktimi i zhurmave – Te kete reduktim inteligjent te zhurmave.
- Kunder mjegulles – te kete mundesi te rregulloje parametrat ne menyre inteligjente qe te kete pamje sa me te mire kur ka mjegull.

Analiza Video

- Karakteristikat:
 - Te krijoje alarm per kushtet e meposhtme:
 - Kalim vije.
 - hyrje /dalje nga nje zone.
 - Ndjekja e nje rruge.
 - Loitering (kur vertitesh ne nje zone te caktuar).
 - Objekte te lena diku apo objekte te marra ne menyre te pa autorizuar.
 - Numerim njerezish.
 - Llogaritje e dendesise ne turma
 - Tampering.
 - Te Suportoje gjithashtu:
 - Ndjekje 3D per objekte.
 - Ndjekje 3D per njerez.
 - Te mund te beje kalibrim automatik duke perdorur sensorin gyro.
 - Te detektoje fytyrat.
 - Te suportoje filtrimin e objekteve sipas:
 - Kohezgjatja
 - Madhesia
 - Raportet
 - Shpejtesia
 - Drejtimi
 - Ngjyra
 - Te suportoje teknologjine Machine learning ne menyre qe perdoruesi te percaktoje objektet me interes dhe kamera te funksionoje si detektore per objektet e percaktuara nga perdoruesi qofshin keto objekte ne levizje apo jo.



Funksione Shtese

- Maska per privaci – 8 Zona te pavarura, plotesisht te konfigurueshme.
- Stampa ne video – Emri, Logo, Koha, Mesazhe alarmi.
- Funksione te tjera – Pasqyrim i pamjes, Rrotullim i pamjes.

Memori Lokale

- Ram i brendshem – 5s regjistrim per prealarm.
- Te suportoje karte memorie deri ne 2 TB.
- Memory card slot – Dual SDXC / SDHC / SD card
- Dual SD-card te mund te funksioje si: - Mirror (redundant storage), -Failover, -Extend, -ANR (Automatic Network Replenishment).
- Te suportoje Industrial SD cards.

Input/Output

- Hyrje alarmi (input) – minimumi 2
- Dalje alarmi – minimumi 1
- Hyrja Audio – minimumi nje linje mono.
- Dalje Audio – minimumi nje linje mono.
- Rrjeti – RJ45 i skermuar.
- Sigures mbrojte per Ethernet deri ne 1kV.




Audio Streaming

- Standard G.711, kampionim 8kHz.
- L16, kampionim 16 kHz.
- AAC-LC, 48 kbps me kampionim 16kHz.
- AAC-LC, 80kbps me kampionim 16kHz.
- Streaming – Full-duplex / half

duplex. Software

- I konfigurueshem ne remote.
- Konfigurueshem me web browser ose software i konfigurimit. Rrjeti

- Protokolle: IPv4, IPv6, UDP, TCP, HTTP, HTTPS, RTP/RTCP, IGMP V2/V3, ICMP, ICMPv6, RTSP, FTP, ARP, DHCP, APIPA (Auto-IP), NTP (SNTP), SNMP (V1, V3, MIB-II), 802.1x, DNS, DNSv6, DDNS, SMTP, iSCSI, UPnP (SSDP), LLDP, SOAP, CHAP, digest authentication.
- Etherneti – 10/100 Base-T, auto sensin, Half/full duplex.
- Integrimi – Onvif Profile S; Onvif Profile G; Onvif Profile T; GB/T 28181

Kushtet e ambientit

- Temperatura e punes – -50°C deri ne +60°C.
 - Temperatura e magazinimit – -30 °C deri ne +70 °C.
 - Lageshtira e punes – 5% deri ne 93% lageshtire relative pa kondense.
 - Rezistenca ndaj impakteve – IK10+
 - Mbrojtja ndaj ujit/pluhurit
 - IP66. Siguria e te dhenave
 - Te kete Crypto Coprocessor (TPM) – RSA 2048 bit, AES/CBC 256 bit.
 - Certifikata PKI – X.509
 - Enkriptim – End to End me VMS qe suporton. Ne rrjet: TLS 1.0/1.2, AES128, AES256. Ne memorien lokale: XTS-AES.
 - Autentifikim Video – checksum, MD5, SHA-1, SHA-256
- Certifikime te produktit: CE

TELEKAMERA DOME IP , INTELIGJENTE ME ANALIZE VIDEO

Per detyren qe do te kryejne keto kamera duhet te :

- Te beje pozicionimin (pan, tilt, roll, zoom) ne remote ose wireless pa qene nevoje te preket kamera (kjo gje ndihmon nese ne te ardhmen duam te ndryshojme fushapamjen).
 - Analize video e integruar ne kamer.
 - Rezolucion te larte 4MP dhe sensor te madh 1/1.8" per te kapur pamje te qarte dhe ne mungese te drites.
- Kompensim te madh drite (HDR) per te pare cdo detaje edhe ne skenat e erreta me mungese drite por dhe ne skenat me ndricim te larte.
- Te kete memorie lokale (SD Card) dhe ne mungese te lidhjes me serveri te regjistroje ne memorie lokale. Ne momentin e lidhjes regjistrimet ne memorien lokale ti kalojne automatikisht serverit.
- Te kete dy slote per SD card industriale. Keto slote te mund te konfigurohen si mirror ose failover.
 - Te kete mbrojtje dhe siguri te larte te te dhenave.

Te dhenat teknike si me posht:

ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E 061013



Ushqimi

- PoE (48 VDC) dhe/ose

-

24 VAC

Sensori

- Tipi i sensorit $\geq 1/1.8$ – inch

CMOS. Lente

- 4.4 deri ne 10 mm P-iris.
- zoom dhe fokus i

motorizuar. Ndjeshmeria

- Me ngjyra ≤ 0.0078 lux
- Mono ≤ 0.0008 lux.

Performanca Video – High Dynamic Range

- Dynamic Range (WDR) ≥ 140 dB.

Video Streaming

- Kompresimi Video – H.265, H.264, M-JPEG
- Streaming – Disa streame te konfigurueshme ne H.264, H.265 dhe M-JPEG, frame rate dhe bandwidth i konfigurueshem.
 - Frame rate – 1 deri ne 60 fps. Rezolucioni Video (HxV)
 - 4.1MP – 2688 x 1520
- Instalimi i kameres
 - Pan, Tilt, Roll, Zoom dhe Fokus te motorizuar.
 - Komisionim wireless duke perdorur protokollin IEEE 802.11 b/g/n. Funksionet Video – Ngjyrat
 - Parametra te rregullueshem te figures – Kontrasti, Ndricimi, Saturation
 - Balancimi i te bardhes – 2500 deri ne 10000K. Funksionet Video – ALC
 - Dite/Nate – Auto, Me ngjyra, Bardh e Zi.
 - Ekspozimi – AES (Automatic Electronic Shutter), Fikse (1/25 deri ne 1/15000).
 - Reduktimi i zhurmave – Te kete reduktim inteligjent te zhurmave.
- Kunder mjegulles – te kete mundesi te rregulloje parametrat ne menyre inteligjente qe te kete pamje sa me te mire kur ka mjegull.

Analiza Video

- Karakteristikat:
 - Te krijoje alarm per kushtet e meposhtme:
 - Kalim vije.
 - hyrje /dalje nga nje zone.
 - Ndjekja e nje rruge.
 - Loitering (kur vertitesh ne nje zone te caktuar).
 - Objekte te lena diku apo objekte te marra ne menyre te pa autorizuar.
 - Numerim njerezish.
 - Llogaritje e dendesise ne turma
 - Tampering.
 - Te Suportoje gjithashtu:
 - Ndjekje 3D per objekte.
 - Ndjekje 3D per njerez.
 - Te mund te beje kalibrim automatik duke perdorur sensorin gyro.
 - Te detektoje fytyrat.
 - Te suportoje filtrimin e objekteve sipas:
 - Kohezgjatja



- Madhesia
- Raportet
- Shpejtesia
- Drejtimi
- Ngjyra

➤ Te suportoje teknologjine Machine learning ne menyre qe perdoruesi te percaktoje objektet me interes dhe kamera te funksionojte si detektore per objektet e percaktuara nga perdoruesi qofshin keto objekte ne levizje apo jo.

Funksione Shtese

- Maska per privaci – 8 Zona te pavarura, plotesisht te konfigurueshme.
- Stampa ne video – Emri, Logo, Koha, Mesazhe alarmi.

- Funksione te tjera – Pasqyrim i pamjes, Rrotullim i

pamjes. Memori Lokale

- Ram i brendshem – 5s regjistrim per prealarm.

Te suportoje karte memorie deri ne 2 TB.

Memory card slot – Dual SDXC / SDHC / SD card

Dual SD-card te mund te funksioje si: - Mirror (redundant storage), -Failover, -Extend, -ANR (Automatic Network Replenishment).

- Te suportoje Industrial SD cards. Input/Output

- Hyrje alarmi (input) – minimumi 2
- Dalje alarmi – minimumi 1
- Hyrja Audio – minimumi nje linje mono.
- Dalje Audio – minimumi nje linje mono.

- Rrjeti – RJ45 i skermuar.

- Siguresse mbrojtje per Ethernet deri ne 1kV. Audio Streaming

- Standard G.711, kampionim 8kHz.
- L16, kampionim 16 kHz.
- AAC-LC, 48 kbps me kampionim 16kHz.
- AAC-LC, 80kbps me kampionim 16kHz.
- Streaming – Full-duplex / half

duplex. Software

- I konfigurueshem ne remote.
- Konfigurueshem me web browser ose software i konfigurimit. Rrjeti

- Protokolle: IPv4, IPv6, UDP, TCP, HTTP, HTTPS, RTP/RTCP, IGMP V2/V3, ICMP, ICMPv6, RTSP, FTP, ARP, DHCP, APIPA (Auto-IP), NTP (SNTP), SNMP (V1, V3, MIB-II), 802.1x, DNS, DNSv6, DDNS, SMTP, iSCSI, UPnP (SSDP), LLDP, SOAP, CHAP, digest authentication.

- Etherneti – 10/100 Base-T, auto sensin, Half/full duplex.
- Integrimi – Onvif Profile S; Onvif Profile G; Onvif Profile T; GB/T 28181

Kushtet e ambientit

- Temperatura e punes – -50°C deri ne +60°C.
- Temperatura e magazinimit – -30 °C deri ne +70 °C.
- Lageshtira e punes – 5% deri ne 93% lageshtire relative pa kondense.
- Rezistenca ndaj impakteve – IK10+
- Mbrojtja ndaj ujit/pluhurit

– IP66. Siguria e te dhenave

- Te kete Crypto Coprocesor (TPM) – RSA 2048 bit, AES/CBC 256 bit.
- Certifikata PKI – X.509



- Enkriptim – End to End me VMS qe suporton. Ne rrjet: TLS 1.0/1.2, AES128, AES256. Ne memorien lokale: XTS-AES.
- Autentifikim Video – checksum, MD5, SHA-1, SHA-256
- Certifikime te produktit: CE

TELEKAMERA IP PTZ INTELIGJENTE ME ANALIZE VIDEO

Per detyren qe do te kryejne keto kamera duhet te :

- Infra red i integruar edhe per distanca te gjata (deri ne 320 metra).
- Analize video e integruar ne kamer.
- Kompensim te madh drite (HDR) si dhe ndjeshmeri te larte ndaj mungeses se drites.
- Te kete memorie lokale (SD Card) dhe ne mungese te lidhjes me serveri te regjistroje ne memorie lokale. Ne momentin e lidhjes regjistrimet ne memorien lokale ti kalojne automatikisht serverit.
- Te kete mbrojtje dhe siguri te larte te te dhenave.
- Fshirese xhami me sensor shiu per te rritur cilesin e pamjes ne kohe te keqe.
- Rezulucion 4MP ne 60 fps me zoom optik deri

ne 30x. Te dhenat teknike si me posht:

Ushqimi

- PoE sipas standartit IEEE 802.3bt dhe/ose
- 24 VAC

Sensori

- Tipi i sensorit $\geq 1/1.8$ – inch HD

CMOS. Lente

- Te jete ≥ 6.6 deri ne 198 mm.
- Te jete $\geq 30x$ optical zoom.
- Te jete $\geq 16x$ digital zoom.
- Rezolucioni i sensorit – 2688 x 1540

(4 MP) Ndjeshmeria

- Me ngjyra ≤ 0.0101 lux.
- Mono ≤ 0.0016 lux.

Performanca Video – Dynamic Range

- High dynamic range ≥ 133 dB

Video Streaming

- Kompresimi Video – H.265, H.264, M-JPEG
- Streaming – Disa streame te konfigurueshme ne H.264 ose H.265 dhe M-JPEG
- Frame rate – 60 fps ne te gjitha rezolucionet

Funksionet Video – ALC

- Raporti Sinjal-Zhurme (SNR) ≥ 55 dB
- Dite/Nate – Auto (e rregullueshme), Me ngjyra, Bardh e Zi.
- Backlight compesation – on/off

- Kunder mjegulles – te kete mundesi te rregulloje parametrat ne menyre inteligjente qe te kete pamje sa me te mire kur ka mjegull.

- Te kete filter inteligjente per reduktimin e

zhurmave. Analiza Video

- Karakteristikat:
 - Te krijoje alarm per kushtet e meposhtme:



- Kalim vije.
- hyrje /dalje nga nje zone.
- Ndjekja e nje rruge.
- Loitering (kur vertitesh ne nje zone te caktuar).
- Objekte te lena diku apo objekte te marra ne menyre te pa autorizuar.
- Numerim njerezish.
- Llogaritje e dendesise ne turma
- Tampering.

➤ Te Suportoje gjithashtu:

- Te mund te beje kalibrim automatik duke perdorur sensorin gyro.

➤ Te suportoje filtrimin e objekteve sipas:



Kohezgjatja
Madhesia
Raportet
Shpejtesia
Drejtimi
Ngjyra

Funksione Shtese

- Te kete te integruar fshirese xhami me sensor shiu e cila te fshije xhamin ne menyre automatike kur fillon shi.
- Funksione PTZ
 - Pan Range - 360°
 - Kendi Tilt - -90° deri ne 5°
 - Toure – te suportoje minimumi 2 toure te regjistruara deri ne 30 minuta.
 - Te suportoje deri ne 256 pozicione (pre-position). Nrcimi IR
 - Kamera te kete IR te integruar me aftesi detektimi deri ne 320 metra sipas (DORI).
- Kamera gjithashtu te kete te integruar drita LED me ngjyre te bardhe per ti mundesuar operatorit shikuesmeri te plote dhe me ngjyre deri ne 60 metra.
 - Operatori te kete mundesi te fike dhe te ndeze dritat e bardha sipas situates. Privaci
 - Maska per privaci – te suportoje deri ne 32 Zona te pavarura, plotesisht te konfigurueshme. Memori Lokale
 - Te suportoje karte memorie deri ne 2 TB (microSDXC).
 - Te suportoje funksionin ANR (Automatic Network Replenishment).
 - Pre-alarmet te mund te ruhen ne RAM per te ulur konsumin e bandwidth. Nderfaqe
 - Hyrja Audio – te kete minimumi nje linje mono.
 - Dalje Audio – te kete minimumi nje linje mono.
 - Rrjeti – RJ45.
 - Hyrje Alarmi – te kete minimumi 2 hyrje alarmi.
 - Dalje Alarmi – te kete minimumi nje dalje relay per alarmin. Software
 - I konfigurueshem ne remote.
 - Konfigurueshem me web browser ose software i konfigurimit. Rrjeti
 - Protokolle: IPv4, IPv6, UDP, TCP, HTTP, HTTPS, RTP/RTCP, IGMP V2/V3, ICMP, ICMPv6, RTSP, FTP, ARP, DHCP, APIPA (Auto-IP), NTP (SNTP), SNMP (V1, V3, MIB-II), 802.1x, DNS, DNSv6, DDNS, SMTP, iSCSI, UPnP (SSDP), LLDP, SOAP, CHAP, digest authentication.
 - Enkriptimi – TLS 1.0, SSL, DES, 3DES, AES



- Etherneti – 10/100 Base-T, auto sensin, Half/full duplex.
 - Integrimi – Onvif Profile S, Onvif Profile G, Onvif Profile T Kushtet e ambientit
- Temperatura e punes – -40°C deri ne +60°C.
- Temperatura e magazinimit – -40 °C deri ne +60 °C.
 - Lageshtira e punes –deri ne 90% lageshtire relative pa kondense. Siguria e te dhenave
- Sigurimi i kamerave – Mbrojtje me password ne 3 nivele dhe perdorimi i 802.1x me certifikata (EAP/TLS) per tu autentifikuar (per log in ne rrjet).
- Lidhja me kameren nepermjet Web browser ose software client te behet nepermjet protokollit HTTPS ose protokoll te tjere te sigurt qe suportojne protokollin TLS 1.2 me enkriptim AES me 256 bit.
 - Vepimet kriptografike, per autentifikim dhe enkriptim te mund te behen vetem ne modulim TPM, Trusted Platform Module (hardware).
 - Te suportojne Infrastrukturen PKI (Public Key Infrastructure).
- Kamera te suportojne funksionin software sealing (te mos instalohet asnje software ne kamer), vetem firmware i autentifikuar mund te instalohet.
 - Certifikime te produktit: CE
 - Mbrojtje: IP66, IK10.

SWITCH 24 PORTA, POE

- Te jete i Menaxhueshem

Portat fizike

- Numri i portave – 24 ne 10/100/1000
- Buxheti PoE- 370W
- Porta fibër – minimumi 4 SFP.
 - Shpejtësia SFP –

100/1000. Performanca e

Switch

- Memorie RAM – 512 MB.
- Jumbo frame support – 10 KB.
- Arkitektura e switch – Store-and-Forward.
- Switching bandwidth – 56 Gbps.
- Tabela MAC – 16K.
- Forwarding rate $\geq 41\text{Mbps}$ ne 64 Bytes.
 - Flow Control – IEEE

802.3x. Funksionet

- Te suportojne protokollin Rapid Spanning Tree Protocol (RSTP) dhe Multiple Spanning Tree Protocol (MSTP).
- Te suportojne switch-port auto-recovery.
- Te suportojne TFTP dhe NTP.
- IGMP snooping – 1024 grupe.
- Nderfaqja e menaxhimit – Console, Web, Telnet, SNMP 1,2,3, SSH/SSL secure access.
- Maksimumi i vlan aktive - 256
 - Link Aggregation – IEEE

802.3ad LACP Funksione sigurie

- 802.1X features to control access to the network.
- Access Control Lists (ACLs) for IPv6 and IPv4.
- Port-based ACLs for Layer 2 interfaces.
- Multidomain authentication.



- SSH, Kerberos, and SNMP v3 to provide network security by encrypting administrator traffic.
- Te suportoje TACACS+ and RADIUS authentication.
- Internet Group Management Protocol (IGMP) filtering to provide multicast authentication.

Licensa per
telekamera

- Licensat te jene kompatibel me VMS te intaluar ne Sallen e monitorimit. Softwari eshte Bosch Management Video System versioni 10.



7. SISTEMI I AKSESS CONTROL DHE ALARMIT

Implanti do te perbehet:

Centrali kryesor i alarmit per hyrje te padeshiruar

Panele remote te cilet bejne te mundur te perjashtojne nga sistemi zona te caktuar

Sensorete volumetrike

Kontaktet magnetike

Buton silencione per aktivizimin e alarmit ne rastet e emergjences

Etc.

Panel për Akses-Kontroll

- Minimumi 2 GB compact flash.
- Te mund te beje minimumi 2 porta.
- Te suportoje te pakten 2 lexues
- Te suportoje deri ne 200000 perdorues.
- Te kete mundesi te puoje offline.
- Te kete memorie seriale EEPROM.
- Te mund te shtohet memoria deri ne 2 GB me Compact Flesh ose te ngjashme
- Ndërfaqja me pajisje të tjera:
 - o RS485
 - o Ethernet 10/100BaseT (TCP/IP) me RJ45
- Të ketë minimalish 2 ndërfaqe për lexuesit si:
 - o Wiegand ose
 - o RS-485
- Të ketë minimalisht 4 dalje rele për të lidhur kundërbravat.
 - o max. i voltazhit: 30 V DC
 - o max. i rrymës: 1,25 A
- Të ketë minimalisht 4 hyrje të monitoruara.
- Të ketë hyrje per tamper
- Të ketë buton resetimi
- Mbrojtje - IP30
- Te kete ekran LDC
- I montueshem ne shin DIN
- Te jete kompatibel dhe te integrohet me sistemin egzistues Bosch Access Management System versioni 3 ose ekuivalent.



Lexues për Akses-Kontroll

- Lloji i burimit të ushqimit: i vazhduar
- Diapazoni operimit Voltazhi: 8.5V – 16V
- Te suportoje protokollet RS485/OSDP dhe 26 Bit Wiegand
- Te jete IP 65 per montim indoor si dhe outdoor.
- Dalje tamper : Open collector
- Diapazoni i operimit të temperaturës: -25 °C deri 65 °C
- Lagështia: 0 deri 95% (pa kondensim)
- Distanca e leximit te kartave (Kartat ISO) deri ne 6 cm.
- Teknologjia e leximit të kartave: 13.56 MHz. - Te suportoje kartat Mifare.
- Certifikatat dhe Aprovimet: Europe: CE



Krahe
hidraulik

Krahu hidraulik duhet të ketë këto specifikime

- Forca mbyllëse në përputhje me EN 1154 – 1-4
- Gjerësia e derës e rekomanduar – 1100 mm
- Version i njejtë për DIN majtas dhe DIN djathtas
- Produkti i testuar në përputhje me testimin për mbydhjen e derës sipas EN1154
- I përshtatshëm për dyer të mbrojtjes nga zjarri
- Forca e mbylljes e rregullueshme me hapa
- Shpejtësia e mbylljes e rregullueshme
- Veprimi i mbylljes i rregullueshëm me valvul
- Rregullim i pozicionit të forcës mbyllëse
- Valvul e sigurisë kundër dëmtimeve të qëllimshme
- Valvola termo-kontrolluese

Elektromagnet

Elektromagneti duhet të ketë këto specifika

- Tension i punës: 12/24 Vdc
- Rrymë: min. 500 mA në 12 V / min. 250 mA në 24 V
- Pesha mbajtëse: min. 300 Kg.

Karta Akses kontrolli

- Karte plastike PVC
- Enkriptimi : 128 bit.
- Frekuenca e transmetimit : 13.5 Mhz



Sensor Levizje



- Te suportojte funksionin Anti-mask duke perdorur 2 teknologji te ndryshme.
- Te kete infrared passiv PIR.
- Te kete radar doppler me mikrovale (microwave Doppler radar).
- Pershtatje ndaj zhumave te ambientit ne menyre automatike.
- Te kete rezistencen EOL te integruar dhe te mund te perzgjidhet me mikroceles.
- Me teknologji per te detektuar mbulimin dhe kamuflimin.
- Te kete rreze monitorimi minimumi 15m.
- Te jete imun ndaj interferencave te valeve radio te jashtme sipas standarit EN50131-5-3.
- Te kete mundesi kompesimi automatik te temperatures per te detektuar persona ne cdo lloj temperature.
- Te jete immune nga kafshe te vogla (deri ne 4.5 kg).
- Te kete plastike rezistente.
- Tensioni i pune 9-12 VDC.
- Te kete dalje per alarm, dalje per trouble dhe dalje per tamper.
- Kontakten te jene normalishte te mbyllura (NC).
- Temperatura e punes -20°C deri ne +55°C.



Kontakt Magnetik

- Te jete I montueshem në sipërfaqe ose inkaso në varësi të derës.
- Te kete dalje per Tamper.
- Ngarkesa e lejuar $\leq 3\text{Watt}$
- Rryma e komutimit deri 100mA
- Tension i komutimit $\leq 30\text{V}$
- Distanca paralele 2 deri ne 6 mm
- Standarti i mbrojtjes IP68

Buton exit emergjence

- Funksioni kryesor : nderpreja e energjise te nje mekanizmi ne rastet emergjente.
- Rryma : 3 A;
- Tensione: 36 VDC;
- Temperatura e funksionimit: da -10°C a +50°C;
- Te kete interutor bipolar.
- Gjendja e pulsanit N/C , N/O
- Te jete I mbrojtur nga aktivizimet aksidentale
- Te jete I monitoruar nga sistemi qendror

8. SISTEMI I AUDIO-KONFERENCES

Sistemi do të jetë i kontrolluar nga **Njesia Qendrore e Kontrollit Dixhitale** e ky sistem do ndertohet sipas cilesive dhe specifikimet teknike te meposhtme:

1. Pajisja qendrore e kontrollit te sistemit.

Kjo pajisje duhet te kryejë kontrollin e të gjitha funksioneve të sistemit :

Te kontrollojë deri ne 30 kanale Audio.

Te menaxhojë njesite e perkthimit.

Te menaxhojë njesite mikrofoni.

Pajisja duhet te ketë grafik LCD display me ndricim te brendshem.

Të ketë te perfshire nje nderfaqje audio te aktivizuar Dante per interkoneksion dhe nderveprim me sisteme audio dixhitale te paleve te treta.

Te ketë funksionalitetin e lidhjes jo me pak se 30 pajisje dalese mikrofoni.

Frequency Response	20 ~ 20KHz
Shpejtesia e lidhjes	Min. 1Gbps
Numri maksimal i kanaleve hyres	Min.30
Numri min. I kanaleve te perkthimit	30
Kontroll hyrje -Dalje	Nderfaqe rrjeti TCP/IP Nderfaqe RS232
Audio Input	AES / EBU input dhe output (XLR)
	1 input analog (IN) XLR balancuar
Audio Output	Pesë dalje analoge XLR-plug: 1 Master
Dante™ multi-channel audio në rrjet	Po deri ne 4(kater) porta.
Te mbrojtura nga qarku i shkurtër dhe mbingarkesat	Po
Lidhja midis 1 ose me shume njesive	D9-Kabell
Power Supply	4(kater) power supply te pavaruara +HOT SWAP functionality
Installation	19" cabinet



2. Njesi autonome per pjesmarresit.

- Mikrofoni dhe autoparlanti i njesise do t`u jape mundesin pjesmarresve ne mbledhje, te flasin dhe te degjojne.
- Mikrofoni te kete nje indikator LED ne forme unaze qe ndizet sa here qe mikrofoni eshte aktiv.

Altoparlanti te fiket kur mikrofoni eshte i ndezur ose kur kufjet jane te lidhura me paisjen.

Gypi i mikrofonit te jete fleksibel per te ndryshuar pozicionin sipas nevojës.

Te kete mundesi zgjedhje te gjatesise se tubit fleksibel te mikrofonit.



Karakteristika	
Sample rate	48kHz
Rezucion	24BIT
Frequency response:	20 - 20,000 Hz
Porte Jack socket	Po

3. Pajisja qendrore e perkrthimit

- Të ketë 8 dalje audio në kanal, mund të përdoret për të monitoruar ose regjistruar. (për të suportuar transmetimin e audios në të gjitha rastet në varësi të pjesëmarrësve të mundshëm në aktivitetet)
- Të ketë ndërfaqen e daljes së sinjalit jo më pak se 2(dy) kanalesh (BNC).
- Të punojë në frekuencë të lartë të transmetimit (brezi 2-6MHz),
